

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË- Departamenti i Krimeve të Rënda, Gjyqtari Shaqir Zika, Kryetari i Trupit Gjykuese, dhe gjyqtareve Ilijana Hoti dhe Manduhije Sylja, anëtare të Trupit Gjykuese, me sekretaren juridike Bute Ramosaj, në çështjen penale kundër të akuzuarit L. N. N. nga Gjakova, për shkak të veprës penale të blerjes, posedimit, shpërndarjes dhe shitjes të pa autorizuar e narkotikut të rrezikshëm dhe substancave psikiotropike nga neni 229 prg 1 si bashkë kryes lidhur me nenin 23 të KPK-se, i akuzuar me aktakuzën e Prokurorisë Komunalë në Gjakovë tani Prokuroria Themelore në Gjakovë-Departamenti i Krimeve të Rënda, PP.nr. 91/ 2010, datë 23.06.2010, në seancën e shqyrtimit kryesor të mbajtur më datën 26.01.2017, me pjesëmarrjen e Prokurorit të Shtetit të PTH në Gjakovë Agron Matjani, i akuzuari L. N., me dt. **30.01.2017** shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari: L. N., nga i ati N. dhe ëma M. e gjinisë K., i lindur ..., në Gjakovë, i martuar i ati i dy fëmijëve, punëtor ka zejen e vete private dhe merret me zdrukthëtari ka të kryer shkollën mesme, i gjendjes së dobët ekonomike, Shqiptar Sh. I R. Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Për shkak së:

Pa pasur autorizim janë furnizuar me substancë narkotike të llojit “heroin” në sasi rreth 3.25 gr, me qëllim të përdorje të vënies në qarkullim apo shitje ashtu që me dt. 03.03. 2010, rreth orës 22:00 min, i pandehuri L. N. me auto veturën e tij të llojit “Mercedes “ ka takuar qytetarin Sh. B. ka marrë atë me veti dhe me të shkuar në shtëpinë e të pandehurit B. U. që gjendet në rrugën “UÇK-se”, dhe gjersa Sh. i ka ndenjur në auto veturë të pandehurit L. ka hyrë te i njëjti dhe ka blerë narkotikun në sasi të cekur me lartë në vlerë prej 30€, pastaj ka dal dhe posa ka marrë të hyre në auto veturën është ndal për kontroll nga ana e Patrullës Policisë dhe gjatë bastisjes që është bërë në xhepat e të pandehurit L. i është gjetur sasia e narkotikut e cila edhe është sekuestruar.

- me çka ka kryer veprë penale të blerjes, posedimit, shpërndarjes dhe shitjes të pa autorizuar e narkotikut të rrezikshëm dhe substancave psikiotropike nga neni 229 prg 1 si bashkë kryes lidhur me nenin 23 të KPK-se.

Andaj Gjykata me aplikimin e neneve 6, 17, 41, 46, 49, 50,51,52,62,73, dhe nenit 229 prg.1 si bashkë kryes lidhur me nenin 23 të KPK-së dhe neneve 359 par. 2, të KPPK-se, të akuzuarin e gjykon me :

I SHQIPTON DENIM KUMULATIV

Duke ja shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet posë që i akuzuari në afate prej 2 (dy) vite, nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale, dhe

DËNIM ME GJOBË në shume prej 300 (tre qind) €, te cilin dënim detyrohet të përmbushë në afat prej 1 (një) muaj, nga dita e pranimit te aktgjykimit te plotfuqishëm, po qe se nuk e paguan gjobën, dënimi me gjobe do te zëvendësohet me dënim me burgim ne kohëzgjatje prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, duke llogaritur për çdo dite burgimi me nga 20 €.

I shqiptohet dënimi plotësues konfiskimi i substancës narkotike e llojit “ heroin” në peshe 3.25 gr.

I akuzuari obligohet që në emër të shpenzimeve të procedurës penale ta paguaj shumën sipas llogarisë përfundimtare të kësaj gjykate dhe në emër të paushallit gjyqësor shumën prej 50- €, e krejt këto në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Komunale ne Gjakove tani Prokurori Themelore ne Gjakovë,- Departamenti për Krime të Rënda, ka ngritur aktakuzën PP/I nr. 91/10 dt. 23.06.2010, kundër te akuzuarit kundër te akuzuarve L. N. dhe B. U. qe te dyte nga Gjakova, për shkak te veprës penale te blerjes, posedimit, shpërndarjes dhe shitjes te pa autorizuar e narkotikut te rrezikshëm dhe substancave psiotropike nga neni 229 prg 1 si bashke kryes lidhur me nenin 23 te KPK-se, e cila lëndë është kthyer në rigjykim nga Gjykata e Qarkut ne Peje, ne aktvendimin AP.nr. 55/2012.

Gjykata ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor ku prezent ka qenë përfaqësuesi i akuzës Prokurori i Shtetit Agron Matjani, i akuzuari L. N., ndërsa nuk ka qene prezent i akuzuari B. U. i cili gjendet ne boten e jashtme për të cilin është lëshuar flete rreshtimi vendor.

Para leximit te akuzës Prokurori i Shtetit Agron Matjani i ka propozuar Trupit Gjykuese, që lënda kundër te akuzuarit B. U. nga Gjakova, te veçohet procedura dhe te vazhdohet me shqyrtim kryesore me te akuzuarin L. N.

Pas leximit te aktakuzës ne seancën e shqyrtimit kryesor, Gjykata është bindur se i akuzuari L. N., ka kuptuar aktakuzën, i është dhënë mundësia qe te deklarohet për pranimin ose mos pranimin e fajësisë.

Me këtë rast Gjykata ka udhëzuar te akuzuarin për rendësin dhe pasojat e pranimit te fajësisë ne kuptim ne nenit 326 te KPPK-se, kështu qe pas shpjegimeve te bëra nga trupi Gjykuese, i akuzuari ka deklaruar se është plotësisht i vetëdijshëm për rendësin e pranimit te fajësisë dhe ka shtuar se ky deklarim paraqet shprehje te vullnetit te tij te lire, pasi qe është kryes i kësaj vepre penale andaj ne tërësi ka pranuar fajësinë sipas te gjitha pikave te aktakuzës, dhe se pranimi i fajësisë është i mbështetur ne provat te cilat i janë ofruar Gjykatës ne aktakuze dhe ata kallëzimi penale, Stacionit Policore Njësi i Hetimeve 2010-DB-0298, te dt. 08.03.2010, ekspertizën e laboratorit Qendrore te Kriminalistikes te Policës së Kosovës me nr. 2010-0657, te dt., 26.03.2010, ku nga kjo

ekspertize rezulton se ekzaminimit i substancës pluhur me ngjyre kafe te çelt, nga dëshmia # nr. 1 ka rezultuar se është prezent “Heroina” ne peshe prej 3.25 gr.

Pas deklarimit te akuzuarit L. N., për pranimin e fajësisë Kryetari i trupit gjykues kërkoj qe mendimin e vet ta jep Prokurori i Shtetit.

Prokurori i Shtetit Agron Matjani, deklaroi se pasi qe i akuzuari L. N. ne fillim te seancës së shqyrtimit gjyqësor ka pranuar fajësinë për vepër penale qe i vihet ne barrë sipas aktakuzës, propozoi qe te pranohet pranimin i fajësisë pasi qe i akuzuari ka pranuar ne mënyrë vullnetare pa presion dhe ndikim nga askush i njëjti ka kuptuar pasojat dhe favoret e pranimit te fajësisë dhe se pranimi i fajësisë është ne pajtueshmëri me provat tjera siç është ekspertiza e ekzaminimit e narkotiku deklarata e dëshmitareve S. Sh. dhe P. P. dhe dëshmitari Sh. B.

Ne vijim, Gjykata duke shqyrtuar pranimin e fajësisë nga ana e te akuzuarit vlerësoi se pranimi i fajësisë paraqet shprehje te vullnetit te lire te akuzuarit, pasi qe i njëjti ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit te fajësisë, dhe pranimi i fajit është bere pas shpjegimeve te nevojshme nga ana e Kryetarit te Trupit Gjykuese me mbrojtësin dhe ky pranim mbështetet ne provat qe janë në aktakuzë konform nenit 326 te KPK-se.

Duke pasur parasysh Gjykata ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e te akuzuarit dhe ka vërtetuar se nuk ekziston asnjë rrethane nga neni 248 te KPPK-se si dhe faktin se janë plotësuar kushtet nga neni 326 te KPPK-se e këtë qeshje penale nuk është zbatuar procedura e provave por gjykata shqyrtimin gjyqësor e ka vazhduar ne fjalën përfundimtare te palëve ne kuptim te nenit 352 te KPPK-se.

Prokurori i Shtetit pranë Prokurorisë Themelore ne Gjakove-Departamenti për Krime te Renda Agron Matjani ne fjalën përfundimtare ka deklaruar pasi qe i akuzuari L. N. nga Gjakova e pranoi veprën për te cilën akuzohet propozoi qe Gjykata te njëjtin te shpalle fajtor dhe te dënoi sipas Ligjit mirëpo gjate caktimit te llojit dhe lartësisë se dënimit te merr parasysh si rrethanat lehtësuese faktin se i akuzuari L. N. ka pranuar fajësinë ka qene korrekt gjate gjykimit, faktin se i njëjti është familjar, i ati i dy fëmijëve.

Po ashtu propozoi qe substanca narkotike e llojit “heroin“ ne peshë prej 3.25 gr, te konfiskohet komfrom dispozitave te nënti 229 prg 5 te KPK-se.

I akuzuari ne L. N. ne fjalën e tij përfundimtar ka deklaruar se e ndjen veten fajtores për veprën e kryer shpreh keq ardhje dhe i propozon Trupit Gjykuese qe me rastin e caktimit te llojit dhe lartësisë se dënimit Gjykata te merr parasysh sidomos rrethanat lehtësueses kam pranuar fajësinë qe ne fillim te seancës se shqyrtimit gjyqësore jam mbajtës i vetëm i familjes, i ati i dy fëmijëve, pendohem për veprimet qe i kam ndërmarrë, kam pasur terapi gjate vitin 2012- 2013 ndërsa ne vitin 2014 prape kam konsumuar dhe nga Gjykata jam dënuar dënim me gjobe 2.000€, ne pa mundësin që te paguaj gjobe i njëjti dënim më është zëvendësuar dhe kam vuajtur burgun. Dhe premtoi qe tani e tutje kurrë me nuk do te përsërisë vepra te tilla.

Me faktet e ofruara si dhe pranimin e fajit nga i akuzuari është vërtetuar gjendja faktike si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi, andaj ne veprimet e te akuzuarit ekzistojnë te gjitha tiparet e veprës penale nga neni 229 prg 1 si bashke kryes lidhur me nenin 23 te KPK-se. Për te cilën veprën penale i akuzuari është penalisht përgjegjës dhe është ndëshkuar si ne dispozitave te këtij aktgjykimi.

Me rastin e matjes se dënimit Gjykata i ka pasur parasysh te gjitha rrethanat nga neni 74 par 1 KPK-se te cilat ndikojnë ne zbutjen apo ashpërsimin e dënimit si rrethane lehtësuese Gjykata ka marre për bazë pranimin e fajit nga i akuzuari, pendimin e tij, sjellja e tij e mire gjate tere procedurës dhe shqyrtimin gjyqësor, gjendjen e tij ekonomike, është mbajtës i familjes i ati i dy fëmijëve, nga koha e kryerjes se veprës penale ka kaluar afati me shume se 6 vite, andaj Gjykata te njëjtit i ka shqiptuar dënimin me kushte dhe gjobe me shprese dhe bindje se me këtë dënimet e shqiptuara do te arrihet qëllimi i dënimit i parapare me dispozitat e nenit 41 te KPK-së .

Vendimi mbi konfiskimin narkotikeve është ne pajtim me nenin 60 prg. 1 pika 2.7 lidhur me nenin 229 prg.5 te KPK-se.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe ne emër te paushallit gjyqësor bazohet ne dispozitat e nenit 453 par 1 lidhur me par 4 të KPPK-se.

Nga aresyrat e cekura me larte dhe me zbatimin e neni 365 par. 1 te KPPK-se është vendosur ne dispozitave te këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NE GJAKOVË,-Departamenti Për Krime të Rënda, P.nr. 775/12, të dt. 30.01.2017

**Procesmbajtësja
Bute Ramosaj**

**Kryetari i trupit gjykues
Shaqir Zika**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund te parashtrohet ankesë , nëpër mjet kësaj Gjykate për Gjykatën e Apelit ne Prishtine ne afati prej 15 ditëve nga dita e pranimit te aktgjykimit.